



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 2729 Prot.

Vau Dejës, me 24.04.2023

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Premte me datë 28.04.2023, ora 14:00. Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

Me këtë rend dite:

1. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2023.
2. Projekt vendim për ngritjen e komisionit të strehimit.
3. Projekt vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2023, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.
4. Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj. Mri Ndoci në Qendren e Përkujdesit Rezidencial për të moshuarit “Besa Barbullush”.
5. Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj. Gjelinë Toma në Qendren e Përkujdesit Rezidencial për të moshuarit “Besa Barbullush”.
6. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së shtetasit Faik Dan Shegaj i dëmtuar nga djegia e banesës me datë 22.03.2023, banorë i Bashkisë Vau Dejës.
7. Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim për dhënien në përdorim, të sipërfaqes prej 31.028428 ha, pjesë e pasurisë nr.736 dhe nr.738, Zk nr.3769, e llojit “ Kullotë “,(Livadh) në fshatin Vig, Njësia Administrative Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës “ Për ndërtim parku fotovoltai, stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.”
8. Projekt vendim për miratimin e planit të parandalimit dhe shuarjes së zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2023.
9. Të ndryshme.

Komisionet e këshillit do të mbledhen ditën e Ejte, datë 27.04.2023 ora 09:30 në Nj/A Bushat.

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

- Frano Ndoja – Kryetar
- Albina Livadhi – Zv/Kryetar
- Lush Doçi – Sekretar

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave, mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Sulejman Hasmegaj – Kryetar
- Gani Zagani – Zv/Kryetar
- Aleko Dodani – Sekretar

Komisioni i Siguri së Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.

- Jak Cara
- Frano Ndoja
- Afrim Kapidanja

Kryetari Këshillit

Mark BISHA

